



**AKT-THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BERDICA CEMENT" sh.p.k.**

Sot, me dt. 21.05.2010 krijohet shoqeria:
"BERDICA CEMENT" shpk nga:

-BEHAR BERDICA i biri i Jonuz e Myzejezen i dt.10.03.1961 banues ne Lagj:Kongresi Permetit,Rr:Leke Dukagjini,Nr.225 Shkoder.

NENI 1

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar, ka vendosur qe te krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "BERDICA CEMENT" shpk, me seli ne Xhafzotaj-Durres (ne Ambientet e Magazinave te Shoqerise PELIKAN sh.p.k), me kapital themelitar 100.000 Leka. Shume e cila eshte likujduar prane Raiffeisen Bank.

Kjo shoqeri e ka qendren ne Xhafzotaj-Durres (ne Ambientet e Magazinave te shoqerise PELIKAN sh.p.k) dhe do te njehet me emrin "BERDICA CEMENT" shpk.

z.BEHAR BERDICA do te jete Administrator i kesaj shoqerie.

Shoqeria "BERDICA CEMENT" shpk ka te drejte te krijoj filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne qdo kohe qe te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovim te organeve kompetente.

NENI 2

Shoqeria "BERDICA CEMENT" shpk gezon statusin e personit juridik.

Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitivave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi.

Statuti i shoqerise i bashkengjitet ketij akti dhe eshte pjese perberese e tij.

NENI 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon te aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete akt, nese ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjasin kete afat.

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni, nese per kete marrin vendim unanimit te gjithe ortaket qe bejne pjese ne kete shoqeri.

NENI 4

Shoqeria "BERDICA CEMENT" shpk do te kete si Objekt veprimtarie:

-Tregtim me shumice e Pakice Marketin-Distributor Import-Eksport, Blerje-Shitje i Artikujve te Ndryshem Ndertimi Cimento, Hekur, Artikuj Industrial, Ushqimore, Blegtoral, Verera, Pije te ndryshme alkoolike dhe pijeve energjike, Artikuj Elektroshtepiake, Kinkalери, Kosmetike Bime Medicinale, Mobileri, Lende Drusore, Makineri e Pajisje, Pjese Kembimi, Materiale Ndertimi, Pajisje Elektrike e Elektronike, Kanceleri, Pajisje Hidrosanitare, Gjeneratore, Linja prodhimi.

-Tregtim me shumice e pakice Imp.-Exp. si dhe Prodhim i Mermerit, Granitit Blloqeve te Palleve te Betonit, Dyer e Dritare te gjitha llojeve, Pllaka, Xhama e Panele xhami dhe te ndryshme.

-Ndertime te ndryshme civile, Ushtarake, Vepra Kulturimi e Arti, Rruge, Ura, Hekurudha.

-Ndertimin dhe menaxhimin e Bar-Restoranteve, Diskotekave, Pub-eve etj., si dhe qdo operacion tjetër qe bashkohet me veprimtari te mesiperme e qe konsiderohet i perbashkët dhe me leverdi per rritjen e zhvillimin e metejshem te aktivitetit te shoqerise.

NENI 5

Kapitali themelor i shoqerise "BERDICA CEMENT" shpk eshte 100.000 Lek i investuar nga ortaku i vetem i shoqerise z. Behar Berdica ne masen 100% (Njeqind perqind)

I ndare ky kapital ne 100 pjese, vlera nominale e seciles eshte 1000 leke, te gjitha te nenshkruara e shlyera prane Raiffeisen Bank.

NENI 6

Pitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me kapitalin e tyre ne kete shoqeri.

NENI 7

Per detyrimet qe do te krijojen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Ortaket nuk mbajne pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tyre qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

NENI 8

Nuk mund te pranohet ne kete shoqeri si ortak nje person i trete pa pelqimin e te gjitha ortakeve.

NENI 9

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin konfidencial te aktivitetit te shoqerise.

Ortaku qe shkel detyrimin e mesiperme dhe nga kjo shkelje shoqerise i shkaktohet nje dem, eshte i detyruar te shperbleje demin.

NENI 10

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

NENI 11

Konfliktet qe lindin ndermjet ortakeve duhet te zgjidhen me marreveshje midis tyre.

Ne qofte se ortaket nuk merren vesh per zgjidhjen e konflikteve me mirekuptim, kompetent per zgjidhjen e ketyre konflikteve eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

NENI 12

Ortaket kane te drejta kryesore te cilat ushtroh nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve.

Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare te shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin.

-Te kerkojne dhe t'u jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtari te shoqerise (bilanci, libra llogarie).

-Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblese se Ortakeve.

NENI 13

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Ortaket e shoqerise, pasi lexuan me vemendje Aktin e mesiperme dhe e gjeten konform vullnetit te tyre te lire e te plote e firmosen si me poshte.

O r t a k u i V e t e m i S h o q e r i s e

BEHAR BERDICA
Behar Berdica
REPUBLICA E SHQIPERISE
NOTERIA SHKODER



Rep.Nr. 6/6

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me dt.21.05.2010 ne zyren e noterise, para meje Noteres Lumturi S.Hoxha u paraqit personalisht z.Behar Berdica, i cili deklaroi se Akti i Themelimit i mesiperme eshte bere vullnetit te tij.

Per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te Kartes se Identitetit Nr.G103102331 e pasi u binda se i ploteson te gjitha kushtet qe i kerkon ligji i vertetova nenshkrimet e mesiperme.

NOTERE
LUMTURI S. HOXHA

